



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



QENDRA  
MAQEDONASE PËR  
EDUKIM  
QYTETAR



## Projekti për integrimin ndëretnik në arsim

# RAPORT MUJOR

## i Projektit të USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim

shkurt 2017

### I. AKTIVITETE TË ZBATUARA

#### Komponenti 1 - Informimi i opinionit dhe bashkësive

- **Konferencë debatuuese „Biseda të Integruara“.** U mbajt konferencë debatuuese dyditore: “Biseda të integruara” në të cilën morën pjesë mbi 100 nxënës të shkollave të mesme të përkatësisë së ndryshme etnike, me qëllim që të promovohet të menduarit kritik, pjesëmarrja e të rinjve në proceset e sjelljes së vendimeve dhe përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike midis tyre. Studentët mësuan se si të shfrytëzohet debati në jetën reale dhe t’i përmirësojnë aftësitë e tyre për të folur publikisht. Krahas kësaj, profesorët universitarë, gazetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, si Maja Muhiq nga Universiteti i Evropës Juglindore, Nazim Rashidi nga Alsat-M, Mersiha Smailoviq nga LEGIS, Bujar Luma, CBS Loja dhe Iva Mihajlovska, Zyra e Avokatit të popullit, u ftuan që t’i ndajnë përvojat dhe të bisedojnë me nxënësit për dialogun interkulturore dhe llojllojshmërinë kulturore në Maqedoni dhe rolin e të rinjve në zhvillimin e kulturës, debatit dhe mediave.
- **Festivali i arteve skenike dhe praktikave të mira.** Edicioni i dytë i festivalit “BE CREATIVE - BE INTERACTIVE - BE INTERETHNIC”, u organizua me qëllim që të ndahen praktikat e mira nga punëtoritë e realizuara kreative dhe këndet kreative të Projektit të USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim. Këto procese kreative, përmes së cilave kanë kaluar nxënësit e shkollave të mesme nga Republika e Maqedonisë, në pesë vitet e kaluara, patën për qëllim ta përforcojnë pjesëmarrjen e të rinjve në dialogun ndëretnik në mjedisin shkollor dhe t’i rrisin vetëdijen qytetare dhe respektin e të drejtave të njeriut në mesin e të rinjve në Maqedoni përmes qasjes dhe shprehjes kreative. Ky edicion i dytë i festivalit pati për qëllim të jetë shembull praktik dhe i mirë i atyre të cilët dëshirojnë në mënyrë kreative të punojnë me gjeneratën e re dhe të cilët besojnë se orientimi i potencialit kreativ të cilin e posedojnë të rinjtë, përmes metodologjive të ideuara dhe të definuara mirë, mund të bëhen ndryshime. Në festival morën pjesë mbi 110 nxënës të pesë shkollave të cilat kanë zbatuar metodologji të punëtorive kreative dhe metodologjinë e forumit teatral dhe të cilët i prezantuan produktet e tyre të punës 6 mujore dhe interaksionit midis tyre. Gjithashtu në festival morën pjesë edhe aktorët e njohur Sasho Kocev, Keti Donçevska-Iliq, Goran Iliq dhe Osman Ahmeti të cilët ishin të kyçur në këto procese dhe në rolin e mentorëve.
- **Përgatitje për ngjarje solemne përfundimtare të PINAs.** Ekipi i PINA-s filloi me përgatitjet për shënimin solemn të arritjeve të deritanishme në kuadër të projektit në partneritet me institucionet arsimore, komunat, shkollat dhe partnerët dhe bashkëpunëtorët e tjerë. Ngjarja ka për qëllim që të ndahen përvojat dhe progresi në drejtim të bashkëpunimit dhe integritit ndëretnik dhe rrjedhën e mëtejme të këtij procesi të rëndësishëm në sistemin arsimor.
- **Informim i rregullt i institucioneve, komunave dhe shkollave për aktivitetet e PINA.** Një pjesë e aktiviteteve kanë përfshirë edhe azhurnimin e rregullt të informacioneve dhe publikimin e risive dhe tregimeve për rrjedhën e aktiviteteve në faqen e facebook-ut *Integratika*, si dhe në ueb faqen e projektit [www.pmio.mk](http://www.pmio.mk). Gjithashtu, aktivitetet të cilat u

zhvilluan në kuadër të shkollave (të pavarura apo në partneritet me shkollat e tjera), gjatë asaj periudhe kishin mbështetje dhe mbulim medial.

## **Komponenti 2 – Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorive të shkollave dhe arsimtarëve**

- **Realizimi i kampit dimëror.** U realizua kamp dimëror me pjesëmarrjen e gjithsej 32 nxënësve dhe 8 mësimitdhënësve: prej shkollës njëgjuhëshe (SHF Hristian T. Karposh – Kumanovë) dhe tre shkolla fillore më shumëgjuhëshe (SHF Vrapçisht – Vrapçisht, SHF Zhivko Brajkovski – Butel dhe SHF Vëllezërit Milladinov – f. Dobrushevë, Mogillë). Në kamp nxënësit patën mundësi të bashkëpunojnë në grupe të përziera përmes lojërave për komunikim, bashkëpunimit ekipor, realizimit të punëtorive për fotografi, aktiviteteve sportive dhe argëtuese. Pjesëmarrje aktive në kamp patën edhe 8-të mësimitdhënësit përmes punëtorive të veçanta të organizuara për ta.
- **Punëtori për përforsimin e rolit të komunës në ndryshimet për INA.** U mbajtën edhe dy punëtori (më 1 dhe 2 shkurt, 2017) me këshilltarët e komunave të përfshirë në bashkëpunimin e thelluar dhe përfaqësuesit e SIT prej shkollave. Në pesë punëtoritë e realizuara janë përfshirë mbi 200 pjesëmarrës.
- **Trajnim për studentët e fakulteteve pedagogjike.** U realizua trajnimi me 20 studentë të fakulteteve pedagogjike në RM. Qëllimi i trajnimit është pjesëmarrësit – mësimitdhënës të ardhshëm të sensibilizohen për punën dhe të njoftohen me elementet bazë të konceptit për zhvillimin e integritetit ndëretnik përmes procesit arsimor.

## **Komponenti 3 – Shkolla modele**

- **Shfaqje.** Në shkollën fillore modele Sande Shterjoski, Kërçovë u mbajt shfaqje me rastin e patronatit të shkollës. Në shfaqje u performuan më shumë pika në mesin e së cilave edhe dy pika të integruara të përgatitura dhe të realizuara me nxënësit e të gjitha gjuhëve mësimore.
- **Takim pune me përfaqësuesit e komunës dhe drejtorët e shkollave fillore.** Në Kërçovë u mbajt takim pune me përgjegjësit për arsimin prej komunës së Kërçovës dhe drejtorët në shumicën e shkollave fillore të komunës. Janë diskutuar praktikat e deritanishme të bashkëpunimit midis shkollave në nivel të komunës si dhe u bisedua për strategjinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe organizimit të aktiviteteve të ndërsjella edhe në vitin e ardhshëm shkollor.

## **Komponenti 4 - Nxitja e shkollave**

- **Aktivitete për rinovim.** Në vijim janë aktivitetet për rinovim të cilat janë obligim i PINA në shkollën fillore të muzikës “Lazo Micev Rale”, komuna e Kavadarit.
- **Është mbajtur konferencë për prezantimin e praktikave të mira për mirëmbajtjen e shkollave.** Konferenca u mbajt më 10 dhe 11 shkurt 2017 në Hotel Drini në Strugë. Konferencën e ndoqën sekretarë dhe personeli teknik prej 63 shkollave të rinovuara. Në konferencë praktika të mira për mirëmbajtjen e objekteve shkollore prezantuan një përfaqësues i MASH, përgjegjësit për arsimin në komuna, drejtorët e shkollave dhe koordinatorët dhe anëtarët e Ekipeve për rinovim.
- **Pajisje për mirëmbajtjen e objekteve shkollore.** Janë dorëzuar pajisje për mirëmbajtjen e objekteve shkollore në SHFK “Hristijan Todorovski Karposh” në komunën e Kumanovës dhe SHMK “Mosha Pijade”, komuna e Tetovës të cilat janë rinovuar shtesë në vitin 2016.

- **Takime mujore në 15 shkolla të fazës 5 për ndjekjen e punës për mirëmbajtjen e objekteve shkollore.**Të gjitha 15 shkollat e rinovuara në fazën 5 janë vizituar prej personave profesionist të cilët do ta ndjekin punën dhe procedurat për mirëmbajtjen e shkollave me ç'rast u janë dorëzuar plane për mirëmbajtje dhe u është dhënë ndihmë profesionale lidhur me mirëmbajtjen e objekteve shkollore (pozita ndërtimore, sistem për ngrohje, instalime elektrike, higjienë).

### **Monitorimi dhe vlerësimi**

- **Aktivite për monitorim dhe vlerësim.** Monitorimi i aktiviteteve vijuese të PINA si dhe finalizimi i raportit final për vlerësim.

## **II. AKTIVITET VIJUESE PËR MUAJIN E ARDHSHËM**

- Ngjarje solemne përfundimtare e Projektit të USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim.
  - Azhurnim i rregullt i informacioneve dhe publikimi i risive dhe rrëfimeve gjatë aktiviteteve përmes faqes së Facebook-ut Integratika dhe ueb – faqes së projektit [www.pmio.mk](http://www.pmio.mk).
-